



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Qendra e Ofrimit të Shërbimeve  
Publike të Integruara (ADISA)**

Nr. Prot \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**Zyra e Regjistrimit të Pasurive  
të Paluajtshme (ZRPP)**

Nr. Prot \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

### URDHËR I PËRBASHKËT

#### **“Për mënyrën e bashkëpunimit në çështjet e teknologjisë së informacionit ndërmjet ZRPP dhe ADISA për administrimin e sporteleve të pritjes së qytetarëve”**

#### **I. Hyrje**

Për të përmbushur rolin e ADISA-s si një zyrë për pritjen e kërkesave e aplikimeve të publikut për ofrimin e shërbimeve të ZRPP-së Tiranë, ADISA do të mbështetet në teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit të ZRPP-së.

Në mungesë të një sistemi IT si dhe të specifikave që ka ofrimi i shërbimeve të ZRPP-së, ADISA do të ketë akses në platformat e bazave të të dhënave të ZRPP-së, të cilin do ta përdorë vetëm për aq sa është e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Ky urdhër përmban kërkesat minimale specifike në fushën e TIK, që lidhen me mbarëvajtjen e punës së stafit të ADISA-s me qëllim garantimin e cilësisë së të dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve.

#### **Sistemi ALBSReP**

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 375, datë 6.6.2012 për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP) është krijuar baza e të dhënave shtetërore “Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ALBSReP)”, që përmban:

- a) të dhënat për pasuritë e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre, bazuar në të gjithë informacionin e dokumentacionit tekniko-ligjor, kartelave dhe hartave treguese të regjistrimit/hartave kadastrale, të krijuara në format elektronik, për pasuritë e paluajtshme që i janë nënshtruar regjistrimit fillestar;
- b) dokumentet e punës;
- c) dokumentet ku evidentohet mënyra e ndërveprimit me institucionet e tjera;
- ç) elementet e sigurisë;
- d) informacionin për proceset e punës;
- dh) materialet për instruktim, në ndihmë për përdoruesin e sistemit;
- e) ndërfaqe të bazuar në teknologjinë portal;
- ë) funksionet e kërkimit;
- f) raportet statistikore për administrimin e kërkesave dhe elementeve të tjera të lidhura me to, llojin e pasurive të paluajtshme dhe elementeve të tjera të lidhura me to, llojin e pronarëve dhe elementeve të tjera

të lidhura me ta.

Arkitektura teknike dhe funksionale e “Sistemit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” është e orientuar për realizim të shpejtë, të saktë dhe me cilësi të shërbimeve ndaj klientit dhe me kosto minimale. Arkitektura e Sistemit mundëson menaxhimin me sukses të veprimeve të lidhura me pasurinë e paluajtshme, dokumenteve dhe proceseve të punës në përputhje me legjislacionin shqiptar, rregullave e rregulloreve të ZRPP-së.

## II. Objektivi

Qëllimi i këtij urdhri është të përshkruajë kërkesat, në raport me mbështetjen TIK (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit), të ADISA-s për ZRPP-në në ofrimin cilësor të shërbimit në sportel. Gjithashtu përcakton nevojën për ndryshime apo shtesa, që duhet të bëhen në sistemin IT si rezultat i kërkesave të parashtruara nga ADISA.

Duke qenë se kërkesat e ADISA janë specifike dhe implikojnë ndërhyrjen në sistemin e ZRPP-së, është përgatitur një dokument i kërkesave teknike për një modul të përbashkët, i cili mundëson ndërveprimin institucional në kohë reale, duke ruajtur pavarësinë për çdo institucion paraqitur në **ANKESIN I të këtij urdhri**///

Objektivat që duhet të përmbushë përdorimi i teknologjive të komunikimit dhe Informacionit:

- Të ofrojë mundësinë e ndarjes së përgjegjësisë mes dy institucioneve duke garantuar ofrimin e shërbimit cilësor për qytetarët.
- Të rrisë efektivitetin, saktësinë dhe të lehtësojë në koordinimin e punës mes sportelit (ADISA) dhe zyra përpunuese (ZRPP);
- Të ofrojë një proces pune të automatizuar për sportelistët me qëllim ofrimin e shërbimit në një kohë sa më të shkurtër;
- Të lehtësojë stafet menaxheriale të ADISA-s dhe të ZRPP-së në kontrollin, menaxhimin dhe vlerësimin e punës së stafit.
- Të realizojë sa më lart duke respektuar aktet ligjore, rregulloret dhe procedurat e aprovuara nga institucionet shtetërore në përdorimin e TIK.

## III. Zbatimi

Për përmbushjen e objektivave më lart, ZRPP do të mbështesë ADISA, në dy aspekte kryesore teknike: Mbështetje Infrastrukturore IT dhe Akses së sistemin ALBSReP nëpërmjet një moduli të përbashkët. Gjithashtu kërkon mbështetje teknike për mbarëvajtjen e punës. Në vijim paraqiten detaje teknike për secilën.

### Mbështetje Infrastrukturore IT

1. Rrjeti Fizik dhe lidhja në Govnet e sporteleve të ADISA-s në godinën e ZQRPP-së, si dhe lidhja e pajisjeve kompjuterike respektive, do të kryhet sipas rregullave të ndërveprimit të platformës qeveritare të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore, rregulloreve të AKSHI-t dhe ZQRPP-së.
2. ZRPP do t'i japë në përdorim ADISA-s pajisjet IT të specifikuara në **Aneksin II** si dhe do të kryejë furnizimin me materialet e nevojshme sipas marrëveshjes së bashkëpunimit. Për çdo problem teknik të tyre, ADISA do të informojë zyrtarisht ZQRPP-në.

### Sistemi ALBSReP

1. ADISA do të ketë akses në modulën e aplikimit të sistemit ALBSReP sipas nevojave të shfaqura gjatë veprimtarisë. Ky modul do të ketë një administrator për ADISA-n, i cili do të ketë të drejta të plota në sistemin.
2. ZQRPP do të vendosë në përdorim infrastrukturën e nevojshme për modulën e front office.

3. Moduli do të mundësojë krijimin e roleve që ka sistemi dhe rolin e supervizorit, i cili do të ketë detyrë të kontrollojë kërkesat e hedhura nga operatori si dhe të shikojë/printojë raportet menaxheriale.
4. Moduli do të garantojë që vetëm administratori i ADISA-s do të menaxhojë rolin e Operatorit për regjistrimin e kërkesave, duke ndaluar kryerjen e aplikimeve nga ana e Zyrave Vendore të regjistrimit të Pasurive të cilat do të kenë detyrë vetëm përpunimin e kërkesve. Asnjë përdorues i shtuar nga ZRPP-ja **nuk do të ketë akses në shtimin e kërkesave të reja.**
5. Nëpërmjet Sistemit ALBSRep do t'i vihen në dispozicion ADISA-s raporte të të dhënave e transaksioneve, të cilat do të mund të filtrohen sipas periudhës kohore, sportelistit, pagesës, statusit, etj. Në mënyrë specifike ZQRPP do t'i ofrojë ADISA-s edhe raportet në vijim:
  - Raporti i Dorëzimit nga FO në ZRPP  
*Header:* Data e Konfirmimit të Pagesës  
*Fushat:* Nr. Rendor, Numri I Kërkesës, Data e Përfundimit, User, Zona  
 Printim në tre mënyra: Sipas User, Sipas Zonës dhe në Total.
  - Raporti i Dorëzimit nga ZRPP në FO (Datë() = Data e përfundimit) me datë aplikimi >= 01/10/2015  
*Fushat:* Nr. Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Aplikimit, Data e Pagesës, Data e Përfundimit, Data e Dorëzimit
  - Raporti i Dorëzimit nga ZRPP në FO (Datë() = Data e përfundimit) dhe Statusi = i përfunduar.  
*Fushat:* Nr. Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Aplikimit, Data e Pagesës, Data e Përfundimit, Data e Dorëzimit
  - Raporti i Dorëzimit nga ZRPP në FO me datë aplikimi < 01/10/2015  
*Fushat:* Nr. Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Aplikimit, Data e Pagesës, Data e Përfundimit, Data e Dorëzimit
  - Raporti i vonësive Data e dorëzimit > Data e Përfundimit  
*Fushat:* Nr Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Aplikimit, Data e Pagesës, Data e Përfundimit, Data e Dorëzimit
  - Raporti mbi lëshimin e “Vërtetimeve pozitiv/negativ” (për ambasada/studentë)  
*Fushat:* Nr. Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Aplikimit, Data e Pagesës, Data e Përfundimit, Data e Dorëzimit
  - Raporti për dorëzimin në postë:  
 Ky Raport duhet të përmbajë infot përkatëse mbi kërkesat të cilat kanë përfunduar së procesuari nga zyra e ZRPP-Tiranë dhe statusi i kërkesës të jetë statusi, që tregon se kjo e fundit është përfunduar. P.sh, sot raporti mbi kërkesat të cilat datën e Përfundimit e kanë 18/09/2015 dhe statusin përfunduar, nesër raporti përmban kërkesat të cilat datën e përfundimit e kanë 19/09/2015 me statusin “përfunduar”. Ky është Raporti që tregon cilat kërkesa duhet të dorëzojë ZRPP në FO, raport i cili tregon edhe çfarë duhet të niset me postë.  
*Fushat:* Nr. Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Aplikimit, Data e Pagesës, Data e Përfundimit, Data e Dorëzimit
  - Raporti i Financës  
*Header:* Data e Konfirmimit të Pagesës  
*Fushat:* Nr Rendor, Numri i Kërkesës, Data e Përfundimit, User, Zona, Shërbimet me pagesat përkatëse, Vlera, Lloji i Pagesës
6. Moduli do të ofrojë mundësi gjurmimi të aplikimeve nga ndërfaqja e operatorëve të sportelit dhe të InfoPoint në çdo kohë me qëllim informimin e qytetarit për statusin e aplikimit.
7. Moduli do të fshehë emrin e punonjësit të ADISA-s apo ZRPP-së, që ka hedhur apo proceson kërkesën në çdo moment.
8. Bërja e fushës së NID-it/NUIS e detyrueshme.
9. Ne rast se kërkuesi përfaqësohet nga një person tjetër, fushat: “Nëpërmjet Prokurës me Numër:” dhe “Date:” të jenë të detyrueshme.

10. Fushë e detyrueshme për numrin telefonik të kontaktit të aplikuesit.
11. Në mënyrë të detyrueshme duhet të plotësohet patjetër **vetëm** njëra nga “Adresat e Kërkuesit”.
12. ZQRPP do t’i dorëzojë ADISA manualin e përdorimit të sistemit ALBSReP për rolet e përdoruesve të rëna dakord.
13. ZQRPP do t’i ofrojë trajnim ADISA-s për përdorimin e sistemit për të gjitha rolet e përdoruesve.
14. ZQRPP do të informojë ADISA-n për çdo ndërprerje të punës së Sistemit gjatë orarit të funksionimit të sportelit në rast defektsh të përgjithshme të sistemit ALBSRep.
15. Në rastin e Kërkesës për kalim pronësie, në aplikimin online të noterëve, llogaritja e vlerës së tatimit të bëhet nga ZRPP. Pas llogaritjes së Tatimit nga Back Office, “Pasqyra Llogaritëse e Tatimit Për Kalimin e Të Drejtës së Pronësisë” të shfaqet së bashku me “Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme” dhe “Hartën Treguese të Regjistrimit”.
16. Nëse qytetari pasi paraqitet në protokollin e ZVRPP përkatëse dhe informohet se ka mbërritur një shkresë/përgjigje nga një institucion tjetër (psh. ALUIZNIetj.), aplikuesi të paraqesë në sportel dokumentin nga protokollin (i cili ka datë mbërritje, numër protokollin, NID personal, Institucionin nga vjen dokumenti, kodi i institucionit, emri i protokolluesit). Me këto të dhëna operatori të vazhdojë procesin e aplikimit, pa marrë fizikisht dokumentin nga back office, duke hedhur në ndërfaqen e tij në sistem dhënë nga protokollin. Më pas procedura e aplikimit vazhdon normalisht.

#### **Suporti teknik**

1. ZQRPP duhet të garantojë funksionimin e sistemit për të gjithë përdoruesit e ADISA-s sipas roleve që ata kanë nga e hëna në të premten ora **8:00- 16:00**.
2. ZQRPP do t’i ofrojë ADISA-s mbështetje teknike për çdo problem që mund të ketë në sistem.
3. ZQRPP do t’i ofrojë ADISA-s mbështetje teknike për çdo problem apo mosfunksionim që mund të kenë lidhje me sistemin AlbsRep. Në rast mosfunksionimi, ADISA njofton stafin IT të ZQRPP-se nëpërmjet e-mail dhe/ose telefonit. Pas njoftimit nga ADISA, ZQRPP do të ofrojë zgjidhje brenda 15-30 min, ose do të njoftojë ADISA-n nëpërmjet e-mail për hapat e më tejshëm që do të ndërmerren në rast se problemi nuk mund të zgjidhet menjëherë.

**Qendra e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA)**

**Zyra e Regjistrimit të Pasurive Publike të Paluajtshme (ZRPP)**

Drejtor i Përgjithshëm

Kryeregjistruesi

Z \_\_\_\_\_

Z. \_\_\_\_\_